



Pranimi / Drovezat Prilideno / Protocolo Received / Delivered	29-04-2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Organi / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot. U Prot. Prot. No.	Shtesa Pulog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	2078/2021		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.149/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.149/2021 të datës 17.03.2021 të parashtruar nga ankuesja, me adresë Fshati Gjinoc, Komuna e Suharekës, kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.149/2021 e datës 17.03.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.15/17 i datës 23.02.2017 i Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë.
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në pozitën „Drejtor i Departamentit të Inspektoratit Farmaceutik, në Ministrinë e Shëndetësisë, sipas Akt emërimit me numër Nr.01/2439, të datës 31.12.2012, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e 50% të pagës nga dita e pezullimit gjegjësisht nga data 23.02.2017 deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë, për zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj Ankueses, e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Akt Emërimit me numër Nr.01/2439 të datës 31.12.2012 në pozitën “Drejtor i Departamentit të Inspektoratit Farmaceutik

(IFPPM)”, me datë 23.02.2017, Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë nxjerr Vendimi me numër Nr.15/17, me të cilin ankuesen e pezullon nga puna duke u bazuar në njoftimin zyrtar nga Prokuroria e Shtetit Bl.nr.05/2017, të datës 20.02.2017.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, me datë 06.06.2018 nxjerr Aktgjykimin me numër PKR.nr.382/15, me të cilin ankuesen e liron nga akuza. Gjykata e Apelit e Kosovës/Departamenti për Krime të Rënda, me datë 25.11.2020, nxjerr vendimin PAKR.nr.316/2020, me të cilin e refuzon si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.382/2015, të datës 06.06.2018.

Ankuesja, në ankesën e datës 17.03.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, thekson se: “Me datë 08.01.2021 përmes thirrjes telefonike jam ftuar nga zyrtarja e zyrës së personelit për të bërë kërkesë për kthim në punë”.

Ankuesja me datë 11.01.2021, përmes shkresës-kërkesës Nr.01/05-65, i është drejtuar Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë për kthim në vendin e saj të punës.

Ankuesja kundër mos përgjigjes në shkresën e datës 11.01.2021, përmes shkresës, me datë 17.03.2021 parashtron ankesë me numër protokollit 1197/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 23.03.2021 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar në Ministrinë e Shëndetësisë. Me datë 30.03.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokollit:1197/2021, e datës 17.03.2021 e parashtruar në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin PKR.nr.382/15, i datës 06.06.2018, i gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Krime të rënda; Aktgjykimi PAKR.nr.316/2020, i datës 25.11.2020, i Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamentit për Krime të Rënda; Kërkesën e datës 11.01.2021; Vërtetimin e datës 09.02.2021; Vendimi Nr.15/17, i datës 23.02.2017; Emali i datës 04.03.2021; Emali i datës 02.03.2021; Kërkesa për përgjigje e datës 23.03.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 30.03.2021; Akt emërimi i ankueses, Nr.01/2439, i datës 31.12.2012; Kërkesa Nr.05-65/2, e datës 25.03.2021.Prove shtese e datës 29.04.2021;Vendimi me numër 83/14 i datës 07.11.2014 i protokolluar me date 10.11.2014.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankueses dhe duke u bazuar dëshmitë e ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit, konkretisht duke u bazuar në aktgjykimet e lartëcekura ka konstatuar se ankuesja në bazë të Aktgjykimit me numër PKR.nr.382/15 të datës 06.06.2018 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda është liruar nga akuza dhe pafajësia e saj është vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës nëpërmjet Aktgjykimit me numër PAKR.nr.316/2020, të datës 25.11.2020, andaj bazuar në këtë ndaj ankueses nuk rëndojnë asnjë akuzë për të cilën është



akuzuar, kështu që Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që pasi ankuesja është liruar nga të gjitha akuza, duhet të kthehet në vendin e saj të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e saj e punës ashtu siç është e përcaktuar me dispozitat e nenit 63 paragrafin 5 nën paragrafin 5.1, dhe 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili thekson se „5. Nëse nëpunësi civil i akuzuar për kryerje të veprës penale shpallet i pafajshëm: 5.1. ai/ajo do të kthehet në vendin e punës dhe në dosje nuk do të përfshihet asnjë përmendje e procedurës penale dhe/ose pezullimit parandalues; 5.2. asnjë masë disiplinore nuk do të merret kundër nëpunësit civil pas shpalljes i/e pafajshëm ose përjashtimit nga një procedurë penale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ministria e Shëndetësisë respektivisht Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë është i obliguar që ankuesen ta kthej në vendin e punës „Drejtor i Departamentit të Inspektoratit Farmaceutik” sipas Akt emërimit me numër Nr.01/2439, të datës 31.12.2012, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, si dhe ti kompensoj 50% të ardhurave personale të ndaluara me vendimin për pezullim parandalues prej datës 23.02.2017 deri me datën kur kthehet në vendin e punës, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 63 paragrafin 5 nën paragrafin 5.1 dhe 5.2, si dhe nenin 69 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.149/2021.**

**Hysni MUSTAFA**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses,
- Ministrin të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.